



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 28.1.2019

Dokument parlamentar

(Komisioni përgjegjës)

R A P O R T

PËR AKTIN NORMATIV TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.2, DATË 19.12.2018 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.109/2017 “PËR BUXHETIN E VITIT 2018”, TË NDRYSHUAR

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjen e datës 28 janar 2019, shqyrtoi aktin normativ të Këshillit të Ministrave nr.2, datë 19.12.2018 “Për disa ndryshime në ligjin nr.109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar”. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton aktin normativ në cilësinë e komisionit përgjegjës.

Në mbledhje ishin të pranishëm, për të paraqitur projektligjin dhe për të dhënë informacionet e kërkuara nga deputetët, Ministrja e Financave dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie. Ministrja e Financave paraqiti një informacion të hollësishëm mbi ecurinë e ekonomisë së vendit gjatë vitit 2018, si dhe ndryshimet e propozuara me aktin normativ.

II. Baza ligjore.

Akti normativ shqyrtohet nga Kuvendi në përputhje me:

- nenet 101 dhe 160 të Kushtetutës;

- nenin 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- rregullat e përcaktuara në nenet 32-39 dhe kreun III të Rregullores së Kuvendit.

Ky akt normativ është akti i dytë që ndryshon ligjin për buxhetin e vitit 2018. Ndryshimi i parë i këtij ligji është miratuar me aktin normativ të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 26.7.2018, i cili nuk preku treguesit kryesorë makroekonomikë të parashikuar në fillim të vitit, por bëri disa rialokime, për të siguruar dhënien e shpërblimit të pensionistëve dhe shtresave në nevojë, përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të energjisë elektrike, avancimin e projekteve të fushës së ujësjellës-kanalizimeve dhe arsimit profesional, si dhe rritjen e mbështetjes financiare për personelin e disa institucioneve të rëndësishme buxhetore.

III. Zhvillimet ekonomike gjatë vitit 2018.

Gjatë vitit 2018 ekonomia shqiptare vijoi trendin përsheptues të rritjes ekonomike. Rritja reale e PBB, nga 3.8 për qind në vitin 2017, vlerësohet të jetë rreth 4.2 për qind në vitin 2018. Të njëjtin nivel të rritjes ekonomike ka parashikuar edhe FMN gjatë rishikimit të projeksioneve të saj për vitin 2018. Sektorët kryesorë që mbështetën rritjen ekonomike ishin industria dhe shërbimet. Kontribut të rëndësishëm pozitiv dhanë edhe sektorët e bujqësisë dhe ndërtimit. Nga pikëpamja e kërkesës agregate, rritja ekonomike vijoi të mbështetet nga zgjerimi i konsumit, investimeve private dhe eksporteve. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik vijoi të mbështetet nga politika monetare stimuluese e Bankës së Shqipërisë.

Kjo performancë e rritjes ekonomike u reflektua në tregun e punës, ku norma e papunësisë vijoi trendin rënës që prej vitit 2014, kur ishte rreth 18 për qind, duke arritur nivelin 12.7 për qind në vitin 2018. Krahësuar me një vit më parë, norma e papunësisë u reduktua me 1.3 pikë përqindje. Ky tregues parashikohet të reduktohet më tej për çdo vit të periudhës afatmesme.

Përmirësim të mëtejshëm për vitin 2018 shënoi edhe bilanci i pagesave. Këtu ndikoi ngushtimi i defiçitit të llogarisë korrente, ku ndikimin më të madh pozitiv e dha eksporti i shërbimeve, si rezultat i zgjerimit të turizmit. Kontribut pozitiv dha edhe zgjerimi i sufiçitit të llogarisë financiare

e kapitale, ku komponenti më i rëndësishëm pozitiv ishin flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte, të cilat u rritën me 11.3 për qind krahasuar me një vit më parë. Përmirësimi i bilancit të pagesave ndikoi në forcimin e kursit të këmbimit të monedhës vendase kundrejt monedhave të huaja.

Financat publike për vitin 2018, krahasuar me një vit më parë, u karakterizuan nga zhvillime pozitive:

- ***Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit*** u rritën me 4.4 për qind. Nga këto, të ardhurat tatimore, megjithë efektet negative të kursit të këmbimit dhe rritjes së vlerës së TVSH të rimbursuar, u rritën me 5.2 për qind.
- ***Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit*** u rritën me 3.1 për qind, ku kontributin më të madh e dha rritja e shpenzimeve kapitale me 14 për qind.
- ***Defiçiti buxhetor*** vlerësohet të jetë 1.6 për qind e PBB. Balanca primare rezulton pozitive, me një sufiçit primar 0.6 për qind të PBB në vitin 2018.
- ***Borxhi publik*** neto, i zhveshur nga mjetet likuide të qeverisë (kryesisht flukset nga Eurobondi) rezultoi 63.9 për qind e PBB, me një reduktim prej 4.7 pikë përqindje, kundrejt nivelit prej 68.7 për qind që rezultonte në 2017. Ndërsa borxhi publik bruto, në fund të vitit 2018, rezultoi në nivelin 67.2 për qind të PBB, me një reduktim prej thajse 3 pikë përqindje kundrejt vitit 2017. Një arritje e rëndësishme gjatë vitit 2018 ishte emetimi me sukses i eurobondit, i cili jo vetëm siguroi financimin e nevojshëm të ekonomisë së vendit, por edhe ishte një tregues i zhvillimit të qëndrueshëm të saj.

IV. Nevoja e ndryshimeve në buxhet.

Nevoja për ndryshime në buxhet lindi në muajin dhjetor 2018, pas analizës së rezultateve të 11-mujorit dhe qartësimit të plotë të situatës makroekonomike, fiskale e buxhetore vjetore nga Këshilli i Ministrave, ku u konstatua se në disa zëra ekzistonin fonde të lira, të cilat mund të përdorshin në disa destinacione të tjera të nevojshme e prioritare. Për të bërë të mundur përdorimin e këtyre fondeve, lindi nevoja e disa rialokimeve në buxhetin vjetor.

V. Ndryshimet e parashikuara në aktin normativ.

Akti normativ parashikon këto ndryshime në buxhetin e vitit 2018:

1. Rriten shpenzimet për pushtetin vendor me 3.4 miliardë lekë, mbështetur në faktorët e mëposhtëm:

- Tejkalimi i planit të mbledhjes së të ardhurave nga pushteti vendor me 3 miliardë lekë, i ndikuar kryesisht nga performanca mjaft e mirë në mbledhjen e të ardhurave nga taksa lokale;
- Shlyerja nga njësitë e qeverisjes vendore, gjatë vitit 2018, e detyrimeve të prapambetura në shumën 2.1 miliardë lekë;
- Zbatimi, nga disa njësi të qeverisjes vendore, i një sërë projektesh me financim të huaj, të parashikuara në buxhetin fillestar. Për këtë arsye, plani i shpenzimeve me financim të huaj për pushtetin vendor u rrit me 1.3 miliardë lekë;
- Trashëgimi, nga disa njësi të qeverisjes vendore, i fondeve nga vitet e mëparshme.

2. Rialokohen fondet midis projekteve të investimeve publike me financim të brendshëm dhe të huaj, duke zhvendosur burimet nga projektet me ecuri të ngadaltë, drejt projekteve me ecuri të mirë;

3. Pastrohen detyrimet e prapambetura në sektorin e infrastrukturës në shumën 2.2 miliardë lekë;

4. Mundësohet financimi me fonde buxhetore i disa prioritetëve, si siç janë konviktet e studentëve në Bashkinë Tiranë, Stadiumi i Kukësit, Kampusi Universitar Durrës, Teatri i Operas dhe Baletit, Spitali i Traumës etj. Gjithashtu, mbulohen me financim disa objekte të rëndësishme të infrastrukturës rrugore, parashikohen fonde për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të institucioneve buxhetore për zbatimin e vendimeve gjyqësore, pagesën e kostos lokale dhe TVSH, rritet me 1.2 miliardë lekë mbështetja buxhetore për sektorin e energjisë elektrike etj.

VI. Nga diskutimet në Komision.

Gjatë diskutimeve për aktin normativ, deputetët e mazhorancës paraqitën vlerësimin e tyre, si më poshtë:

Së pari, akti normativ ruan të pandryshuar treguesit makroekonomikë e fiskalë të parashikuar në fillim të vitit 2018, duke vijuar tendencën e konsolidimit fiskal, me qëllim ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit dhe menaxhimin me efektivitet të financave publike. Defiçiti buxhetor është në nivelin më të ulët të tri dekadave të fundit. Balanca primare vijon të jetë pozitive që prej vitit 2016. Borxhi publik vijon tendencën në rënie nga njëri vit në tjetrin, për të arritur një nivel prej 60 për qind të PBB deri në vitin 2020.

Së dyti, akti normativ siguron hapësira financiare shtesë për njësitë e vetqeverisjes vendore, duke kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik vendor dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Së treti, riallokimi i fondeve të investimeve publike do të rrisë mbështetjen financiare për projektet me performancë të lartë, duke ndihmuar në avancimin e punimeve dhe përsheptimin e ndërtimit të objekteve prioritare, si dhe rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.

Së katërti, akti normativ do të kontribuojë në pastrimin e detyrimeve të prapambetura të institucioneve buxhetore, për të mundësuar zbatimin e strategjisë së Qeverisë në këtë fushë dhe plotësimin e angazhimeve ndaj FMN.

Lidhur me propozimin e ndryshimeve buxhetore me akt normativ, Komisioni ishte i mendimit se kjo është një procedurë e ndjekur prej vitesh dhe plotëson kërkesat e nenit 101 të Kushtetutës, që janë nevoja, urgjenca dhe përkohshmëria deri në miratimin e ligjit nga Kuvendi. Riallokimi i fondeve buxhetore në destinacionet e rishikuara duhej miratuar brenda një periudhe sa më të shkurtër, për të siguruar bërjen efektive të tyre deri në fund të vitit. Për këtë arsye, ndryshimet

buxhetore duheshin miratuar brenda një periudhe sa më të shkurtër. Ky akt normativ duhet të miratohet nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

Deputetët e opozitës u shprehën kundër ndryshimeve të parashikuara në aktin normativ.

VII. Përfundim.

Mbështetur në argumentet e paraqitura më lart, Komisioni e miratoi aktin normativ të Këshillit të Ministrave me shumicë votash.

RELATORI

Ervin BUSHATI

KRYETARI

Arben AHMETAJ